2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 10 194 753 (dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 194 753 (dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT PËR INTERES PUBLIK "RIKONSTRUKSIONI I BULEVARDIT "JAKOV XOXA""

NR.	PRONARI	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. m²	Çmimi lekë/m²	Amortizimi	Vlera (6x7x8)	Shpenzime administrative 7%	Vlera e ndërtesës	Vlerë trualli	vlera totale/leke	Gjendja juridike e pasurisë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
				TRUALL	120	12458					1,494,960		Inskriptuar në favor të bankës NBG Albania sh.a.
1	Ilirjana Jashar Ramaj	ZK.8532	5/177	NDËRTESË	120	31599	40%	1,516,752	106,173	1,622,925		3,117,885	
	Flamur Bilbil			TRUALL	46	12458					573,068		Konfirmim nga
2	Kafarani	ZK.8532	4/337	NDËRTESË	46	31599		1,453,554	101,749	1,555,303		2,128,371	ZVRPP-ja
3	Arta Gjini	ZK.8532	4/594	NDËRTESË	24	31599	60%	455,026	31,852	486,877		486,878	Konfirmim nga ZVRPP
4	Zhaneta Ristan Furxhiu	ZK.8532	6/261-N2	NDËRTESË	9	31599	60%	170,635	11,944	182,579		182,579	Konfirmim nga ZVRPP-ja
5	Luftar Zalo Agalliu	ZK.8532	6/261-N3	NDËRTESË	8.8	31599	60%	166,843	11,679	178,522		178,522	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	Luftar Zallo			TRUALL	27	12458					336,366		Konfirmim nga
6	Agalliu	ZK.8532	6/251	NDËRTESË	27	31599	60%	511,904	35,833	547,737		884,103	ZVRPP-ja
				TRUALL	27	12458					336,366		Konfirmim nga ZVRPP-ja
7	Arber Agur Bejkaj	ZK.8532	6/249	NDËRTESË	27	31599	60%	511,904	35,833	547,737		884,103	Konfirmim nga ZVRPP-ja
				TRUALL	35	12458					436,030		Inskriptuar në favor të Bankës së Parë të
8	Edmond Miço Thanasi	ZK.8532	6/234	NDËRTESË	32	31599		1,011,168	70,782	1,081,950		1,517,980	Investimeve
	Aleksander			TRUALL	17.6	12458					219,261		Plotësim
9	Zahoaliaj	ZK.8532	6/113-N1	NDËRTESË	17.6	31599		556,142	38,930	595,072		814,333	dokumentacioni
										Vlera totale		**10,194,753**	

Në përcaktimin e vlerës totale të pasurive jemi referuar: udhëzimi nr. 4, datë 30.9.2015 "Mbi miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave miratuar nga EKB" dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Mbi miratimin e vlerës së pasurisë të llojit tokë truall për qytetin Fier.

VENDIM
Nr. 599, datë 31.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRUGËS "DHIMITËR KONOMI", NË ZONËN E UJIT TË FTOHTË, VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall", me një vlerë të përgjithshme prej 27 776 834 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 27 776 834 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA ME EMRAT E PRONAREVE PER PASURITE E PALUAJTSHME QE PREKEN NGA PROJEKTI "NDERTIM I RRUGES DHIMITER KONOMI NE ZONEN E UJIT TE FTOHTE VLORE"

Vlera e truallit me emimin e miratuar me V.K.M- Nr. 89, date 03.02.2016

Zona Kadastrale 8602

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Siperfaqe Trualli	Siperfaqe ndertimi	Çmimi i Truallit Leke/m2	Çmimi i Ndertimi Leke/m2	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truall dhe ndertese	Shenime
1	8602	42/17	Vlore	Bp Ruci, Duni, Mehilli Brisku, etj	92.2		10,903.0		1,005,256.6		1,005,256.6	Mbi kete pasuri ngrihet pasuria nr.42/18-Nd e subjektit Katina Duni dhe 42/17-Nd e Aleks Duni etj
2	8602	42/22	Vlore	P.P.V	4.2		10,903.0		45,792.6		45,792.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
3	8602	42/29	Vlore	Bp Tahiraj dhe Kociaj	8.1		10,903.0		88,314.3		88,314.3	Konfirmohet nga Z.V.R.P.P . Mbi kete pasuri ngrihet pasuria nr.42/29-Nd
4	8602	42/30- T	Vlore	C.Bitaj	17.5		10,903.0		190,802.5		190,802.5	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.Urdher kufizimi
5	8602	42/32	Vlore	P.P.V	36.4		10,903.0		396,869.2		396,869.2	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Kjo pasuri lidhet me pasurine 42/32-nd.
6	8602	42/59	Vlore	Veude Lekdushi	5.6		10,903.0		61,056.8		61,056.8	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
7	8602	42/52	Vlore	Lulfi Metaj	7		10,903.0		76,321.0		76,321.0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
8	8602	42/46	Vlore	Spiro Pando	28.6		10,903.0		311,825.8		311,825.8	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
9	8602	42/48	Vlore	Dallandyshe Hizmo	57.3		10,903.0		624,741.9		624,741.9	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
10	8602	42/69	Vlore	P.P.V	84.5		10,903.0		921,303.5		921,303.5	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Posedohet nga Festim Alimemaj
11	8602	43/6	Vlore	Konfederata Sindikata Shqiptare	6.2		10,903.0		67,598.6		67,598.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
12	8602	43/9	Vlore	Konfederata Sindikata Shqiptare	17		10,903.0		185,351.0		185,351.0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
13	8602	43/10	Vlore	Federata e Sindikates Shqiptare	18.8		10,903.0		204,976.4		204,976.4	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
14	8602	43/129	Vlore	Fotaq Konomi	21.5		10,903.0		234,414.5		234,414.5	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
15	8602	43/132	Vlore	Nikollaq Konomi	37.2		10,903.0		405,591.6		405,591.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
16	8602	43/145	Vlore	Bp Sulaj, Vaka, Mullaj, Duka, etj	9.2		10,903.0		100,307.6		100,307.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P . Sekuestro per Edmond Mucaj
17	8602	150/1	Vlore	Mbivendosje	32.4		204.0		6,609.6		6,609.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P . Kufizim deri ne zgjidhjen e mbivendosjes. Pemetore
18	8602	43/201	Vlore	Trifon Idrizaj	23.7		10,903.0		258,401.1		258,401.1	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
19	8602	43/244	Vlore	Bp Kreshpa	21.6		204.0		4,406.4		4,406.4	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Ullishte
20	8602	43/426	Vlore	Lejla Sullaj	16.1		10,903.0		175,538.3		175,538.3	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
21	8602	43/524	Vlore	Mbivendosje	18.1		10,903.0		197,344.3		197,344.3	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
22	8602	43/388	Vlore	Mbivendosje	160.9		10,903.0		1,754,292.7		1,754,292.7	Kufizim deri ne zgjidhjen e mbivendosjes
23	8602	43/429	Vlore	Mbivendosje	48.8		10,903.0		532,066.4		532,066.4	Kufizim deri ne zgjidhjen e mbivendosjes
24	8602	43/528	Vlore	D. SH. Qeveritare	15.5		10,903.0		168,996.5		168,996.5	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
25	8602	43/267	Vlore	Mbivendosje	38.1		10,903.0		415,404.3		415,404.3	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
26	8602	43/271	Vlore	Mbivendosje	50.4		10,903.0		549,511.2		549,511.2	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
27	8602	43/291	Vlore	Drejtoria e Sherbimit Qeveritar	8.9 + 50.7		10,903.0		649,818.8		649,818.8	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
28	8602	43/273	Vlore	Mbivendosje	118.3		10,903.0		1,289,824.9		1,289,824.9	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
29	8602	44/15	Vlore	Drejtoria e Sherbimit Qeveritar	88.3 + 337.1		10,903.0		4,638,136.2		4,638,136.2	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
30	8602	44/41	Vlore	Kristo Memushaj	36		10,903.0		392,508.0		392,508.0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
31	8602	44/107	Vlore	Bp Aliaj, Dollani, Gega, Xhelaj, Lalike, Velo	110.5		10,903.0		1,204,781.5		1,204,781.5	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
32	8602	44/114	Vlore	Bp Aliaj, Dollani, Gega, Xhelaj, Lalike, Velo	7.3		10,903.0		79,591.9		79,591.9	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P.
33	8602	44/233	Vlore	Mbivendosje	14.4		204.0		2,937.6		2,937.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Kufizim Veprimesh per shkak te Mbivendosjes se konstatuar. Ullishte
34	8602	43/534	Vlore	Mbivendosje	32.7		10,903.0		356,528.1		356,528.1	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Kufizimi I veprimeve deri ne zgjidhjen e mbivendosjes se konstatuar
35	8602	43/309	Vlore	Bp Porozaj	5		10,903.0		54,515.0		54,515.0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
36	8602	43/307	Vlore	Bp Cano, Merkaj	59.65		10,903.0		650,364.0		650,364.0	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
37	8602	43/304	Vlore	Pasho Porozi	80.3		204.0		16,381.2		16,381.2	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Pemetore
38	8602	43/236	Vlore	Mbivendosje	278.8		10,903.0		3,039,756.4		3,039,756.4	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P. Kufizim deri ne zgjishjen e mbivendosjes se konstatuar
39	8602	43/234	Vlore	D.SH.Q	178.5		10,903.0		1,946,185.5		1,946,185.5	Konfirmohet nga Z.V.R.P.P
40	8602	43/235	Vlore	Perparim Memushi	7.8		10,903.0		85,043.4		85,043.4	Konfirmohet nga Z.V.R.P.P
41	8602	43/215	Vlore	Bp Sulaj, Mullaj, Vaka, Duka etj	202.5		10,903.0		2,207,857.5		2,207,857.5	Konfirmohet nga Z.V.R.P.P. Sekuestro konservative vetem per pjesen takuese te Edmond Mucaj
42	8602	43/569	Vlore	Lika Konomi	32.2		10,903.0		351,076.6		351,076.6	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
43	8602	43/568	Vlore	Androniqi Konomi	8.3		10,903.0		90,494.9		90,494.9	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
44	8602	43/565	Vlore	Lika Konomi	39.6		10,903.0		431,758.8		431,758.8	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
45	8602	43/566	Vlore	Nikollaq Konomi	88.7 + 31.1		10,903.0		1,306,179.4		1,306,179.4	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P

Vlera totale 27,776,834

VENDIM
Nr. 600, datë 31.8.2016

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË E MAQEDONISË, PËR LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË GUSHT 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Maqedonisë, në shumën 100 000 (njëqind mijë) euro, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në gusht 2016.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në programin buxhetor 01120, "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh, shpenzime korrente, për t'u përdorur si ndihmë financiare për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit gusht 2016, në Maqedoni.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 601, datë 31.8.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NDËRTESËS E TË MJEDISEVE ADMINISTRATIVE, NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË TE BASHKIA KORÇË, DHE KALIMIN NË PRONËSI TË NDËRTESËS E TË MJEDISEVE ADMINISTRATIVE, NGA BASHKIA KORÇË TE KËSHILLI I QARKUT KORÇË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1223, DATË 3.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PRONËSI KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, sipas formularit bashkëlidhur, për sistemimin e administratës me ambiente pune dhe revokimin e së drejtës së pronësisë për këtë pronë Këshillit të Qarkut Korçë.

2. Kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, sipas planimetrive bashkëlidhur, për sistemimin e administratës me ambiente pune dhe revokimin e së drejtës së pronësisë për këtë pronë Bashkisë Korçë.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1223 datë 3.9.2008, të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli i Qarkut Korçë, Bashkia Korçë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN DHE TRANSFERIMIN E AMBIENTEVE ADMINISTRATIVE PRONËSI TË NJËSIVE VENDORE

Këshilli i Qarkut Korçë

Nr.	Emri i pronës Adresa Pronari	Sip. totale e pasurisë m²	Sip. totale truall m²	Sip. totale ndërtesë m²	Renditja e ambienteve brenda pronës	Lloji i pronës sipas përdorimit aktual	Institucion që ushtron autoritetin administrativ mbi ndërtesën	Kërkohet për transferim
1	Këshilli i Qarkut Korçë Bulevard "Republika" Korçë	4526	3400	1126		Zyrat e Këshillit të Qarkut	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim
2	Garazh i veçuar			72		Garazh	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim
3	Ndërtesë provizore			26.6		Ambiente gjelbërim	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim





VENDIM
Nr. 602, datë 31.8.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 2 207 veta ...".

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, në ndarjen "Gr.28 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor", shtohet nënndarja sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 2, të vendimit, pas fjalëve "... Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave,...." shtohen fjalët "...dhe punonjësit e shërbimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve...".

4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
29	**Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor**	**11**			
	Gjykata e Rrethit Durrës	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Rrethit Lezhë	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Rrethit Sarandë	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Rrethit Tropojë	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Apelit Tiranë	2	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Apelit Durrës	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Apelit Vlorë	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë	3	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj

VENDIM
Nr. 603, datë 31.8.2016

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 413, DATË 25.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME, DHE TROJEVE SHTESË FUNKSIONALE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE TREGTARE, TË OBJEKTEVE SHTETËRORE TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA, TË OBJEKTEVE APO NDËRTESAVE TË SHITURA TË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE, SI DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", të ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.9.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 413, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen procedurat e privatizimit të truallit, sipërfaqe e domosdoshme, për objektet pjesë e kapitalit të shoqërive tregtare (shoqërive me kapital të përbashkët dhe shoqërive aksionare), kapitali i të cilave zotërohet plotësisht apo pjesërisht nga shteti dhe shitja e tyre është bërë nëpërmjet procedurave të likuidimit. Shitja e truallit, sipërfaqe e domosdoshme, për këto objekte do të bëhet në përputhje me genplanin në momentin e shitjes së tyre.".

b) Në fund të shkronjës "c", të pikës 3, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Kopjen e noterizuar të kontratës së shitjes për objektin, të nënshkruar me likuidatorin e shoqërisë, së bashku me genplanin apo planrilevimin e përgatitur nga ekspert i licencuar në momentin e shitjes.".

c) Pas shkronjës "b", të pikës 4, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, duhet të dërgojë kopjen e konfirmuar të dokumentacionit të shitjes së objektit sipas procedurave të likuidimit, për të cilin kërkohet privatizimi i truallit.".

ç) Në fund të pikës 11 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Në rast se edhe nga organet e sipërpërmendura nuk gjendet dosja e vlerësimit (privatizimit apo dokumentacionit që i mungon dosjes) të objektit, atëherë Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, pranon dosjen e privatizimit që ka paraqitur blerësi i objektit apo ndërmarrjes, (kontratën e shitjes, aktin e dorëzimit, autorizim për kalim pronësie, genplanin apo planimetrinë dhe mandatpagesat përkatëse), të njohura këto me vendim gjykate të formës së prerë.".

2. Në kreun II bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen edhe procedurat e shitjes së trojeve shtesë funksionale të shoqërive me kapital të përbashkët dhe të shoqërive aksionare të privatizuara dhe atyre të shitura me procedurat e likuidimit.".

b) Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, mund t'i kërkojë bashkisë përkatëse nëse trualli, i cili kërkohet të privatizohet, përdoret për interes publik apo edhe është pronë e saj, i transferuar në bazë të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar. Në rastet kur ka informacion për truallin që do të shitet se është pjesë e listave të inventarit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, por të patransferuara, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme (AITPP).".

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 604, datë 31.8.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 872, DATË 30.10.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2016, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 872, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, shuma "... 40 258 000 (dyzet milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë ..." zëvendësohet me "... 43 756 000 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë ...".

b) Pasqyra nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me pasqyrën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1
PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	në lekë
1	Shpenzime për paga	25 577 000
2	Sigurime shoqërore	3 914 000
3	Shërbime e furnitura	13 000 000
4	Investime	1 265 000
	TOTALI	**43 756 000**

VENDIM
Nr. 605, datë 31.8.2016

PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS MAKSIMALE, TË KUSHTEVE DHE TË PROCEDURËS PËR DHËNIEN E NDIHMËS "DE MINIMIS"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton vlerën maksimale, kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës "*de minimis*".

2. Ky vendim zbatohet për ndihmat e dhëna në të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, me përjashtim të rasteve kur ndihma jepet:

a) për veprimtaritë e lidhura me eksportin drejt vendeve të tjera;

b) me kusht përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara.

3. Ky vendim zbatohet për ndihmat "*de minimis",* që u jepen ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë aktivitet në disa sektorë të ndryshëm, vetëm nëse ndërmarrja ndan, në mënyrë ligjore ose kontabël, aktivitetet ose kostot e aktiviteteve të ndryshme në atë mënyrë që ndihma "*de minimis*" të përdoret vetëm për sektorin dhe aktivitetin, për të cilët është dhënë.

4. Ndihma konsiderohet "e dhënë" në momentin kur ndërmarrja përfituese fiton të drejtën ligjore për të marrë ndihmën, në bazë të një skeme të ndihmës shtetërore apo të një vendimi individual, pavarësisht nga data e pagesës së shumës së ndihmës "*de minimis".*

5. Në kuptim të këtij vendimi, me "një përfitues të vetëm të ndihmës *"de minimis""* kuptohet çdo ndërmarrje ose një grup ndërmarrjesh që kanë marrëdhënie me njëra-tjetrën, si më poshtë vijon:

a) Një ndërmarrje ka shumicën e së drejtës së votës si aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, në mënyrë direkte ose indirekte;

b) Një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë shumicën e anëtarëve të bordit, këshillit administrativ, të drejtimit ose të mbikëqyrjes së një ndërmarrjeje tjetër, në mënyrë direkte ose indirekte;

c) Një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë ndikim zotërues mbi një ndërmarrje tjetër në bazë të një kontrate ose të statutit, në mënyrë direkte ose indirekte;

ç) Një ndërmarrje aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër kontrollon shumicën e së drejtës së votës të kësaj të dytës në bazë të një kontrate me aksionarë apo me anëtarë të tjerë, në mënyrë direkte ose indirekte.

II. NDIHMA "*DE MINIMIS"*

Ndihma "*de minimis"* lejohet nëse përmbushen njëherësh të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Ndihma dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk e kalon vlerën e përgjithshme 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun III, të këtij vendimi.

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun IV, të këtij vendimi.

III. LLOGARITJA E VLERËS TOTALE TË NDIHMËS *"DE MINIMIS*"

1. Vlera totale e ndihmës shprehet në grant në të holla (*cash*) dhe bazohet në shumën bruto, para zbritjes së taksave ose shpenzimeve të tjera. Në rastet kur ndihma jepet në formë tjetër, vlera e ndihmës është ekuivalenti bruto i ndihmës (EBG).

2. Ndihma që paguhet me këste skontohet në vlerën e saj në momentin e dhënies. Për skontimin përdoret norma e interesit në momentin e dhënies së ndihmës.

3. Në rastin e bashkimit ose blerjes së ndërmarrjeve, ndihma e dhënë para bashkimit ose blerjes duhet të përfshihet në llogaritjen e vlerës totale të çdo ndihme të re "*de minimis*". Ndihma e ligjshme "*de minimis*", e dhënë para bashkimit ose blerjes, mbetet e ligjshme.

4. Në rastin e ndarjes së një ndërmarrjeje në dy ose më shumë ndërmarrje të reja, ndihma *"de*

[1] *Ky vendim është përafruar me rregulloren e Komisionit Evropian nr. 1407/2013, datë 18.12.2013, "Për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën de minimis", numër celex 32013R1407, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian 2013 L 352, f 1 dhe rregulloren nr. 360/2012 të Komisionit Evropian, "Për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën de minimis, dhënë ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të interesit të përgjithshëm, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 2012, L 114, fq 1.*

minimis", e dhënë para ndarjes, i bashkëngjitet pjesës së ndërmarrjes që ka përfituar nga ndihma. Kur shpërndarja e ndihmës nuk është e mundur sipas kësaj mënyre, ndihma "*de minimis"* i shpërndahet secilës pjesë, në përpjesëtim me vlerën e kapitalit të çdo ndërmarrjeje të re, siç është i regjistruar në librat kontabël të ndërmarrjes në datën e ndarjes.

5. Ndihma "*de minimis"* mund të mblidhet me ndihmën "*de minimis"* për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, por nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës "*de minimis"* për këto lloj shërbimesh. Çdo mbledhje e ndihmave të tjera "*de minimis"* nuk duhet të kalojë vlerën maksimale të ndihmës "*de minimis*", të caktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

6. Ndihma "*de minimis"* nuk mund të mblidhet me ndihmë tjetër për të njëjtat kosto ose të njëjtin risk-financim kur mbledhja sjell tejkalimin e intensitetit të ndihmës.

IV. LLOGARITJA E EKUIVALENTIT BRUTO TË GRANTIT (EBG)

1.Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente.

2.Ndihma në formë borxhi ose kredie është transparente nëse:

a)përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi, sipas legjislacionit në fuqi; dhe

b)kredia nuk kalon shumën prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh për dhjetë vjet dhe shoqërohet me garanci që mbulojnë të paktën 50% të kredisë. Kur kredia është më pak se këto shuma ose kur jepet për një kohë më të shkurtër se pesë apo dhjetë vjet, atëherë ekuivalenti bruto i grantit llogaritet (ulet) proporcionalisht; ose

c) ekuivalenti bruto i grantit është llogaritur mbi bazën e normës së interesit që zbatohej në kohën e dhënies së grantit.

3. Ndihma në formën e kapitalit është transparente nëse shuma totale e kapitalit dhënë një ndërmarrjeje nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës *"de minimis*" (injeksion kapitali).

4. Ndihma e risk-financimit në formën e investimit në kapital ose e ngjashme me kapital aksionar është transparente kur shuma totale dhënë një ndërmarrjeje nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës "*de minimis*".

5.Ndihma në formën e garancisë është transparente nëse:

a) përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi, sipas legjislacionit në fuqi;

b) garancia nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe kjo kredi nuk kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për dhjetë vjet. Kur kredia është më pak se këto shuma ose kur jepet për një kohë më të shkurtër se pesë apo dhjetë vjet, atëherë ekuivalenti bruto i grantit llogaritet (ulet) proporcionalisht.

V. NDIHMA "*DE MINIMIS*" PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE

1. Dispozitat e këtij vendimi gjejnë zbatim dhe për ndihmën që u jepet ndërmarrjeve të transportit të mallrave, përveç përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës maksimale të ndihmës, të përcaktuara në këtë kre.

2. Në rastin e ndihmës së dhënë për ndërmarrjet e transportit të mallrave, vlera totale e ndihmës që i jepet një ndërmarrjeje nuk i kalon 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Në rastin kur ndërmarrja e transportit të mallrave ushtron një aktivitet tjetër, të cilit i zbatohet vlera maksimale e ndihmës "*de minimis*" prej 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekësh, kjo ndërmarrje duhet të ndajë, me anë të ndarjes ligjore ose kontabël, aktivitetet ose kostot e aktiviteteve të ndryshme, në mënyrë që aktiviteti i transportit të mallrave të mos përfitojë më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

4. Në rastin e kredive, në kuptimin e pikës 2, të kreut IV, të këtij vendimi, kredia dhënë ndërmarrjes së transportit nuk e kalon shumën prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh për dhjetë vjet dhe shoqërohet me garanci që mbulon të paktën 50% të kredisë.

5. Në rastin e garancive, në kuptimin e pikës 5, të kreut IV, të këtij vendimi, garancia e dhënë ndërmarrjes së transportit nuk i kalon 80% të kredisë që garanton dhe kjo kredi nuk kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 25 000 000

(njëzet e pesë milionë) lekësh për dhjetë vjet.

6. Ndërmarrja e transportit të mallrave nuk mund të përdorë ndihmën *"de minimis"* për blerjen e makinave për transport mallrash.

VI. NDIHMA "*DE MINIMIS"* PËR SHËRBIMET ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK

1. Dispozitat e këtij vendimi gjejnë zbatim dhe për ndihmën që u jepet ndërmarrjeve që ofrojnë shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, përveç përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës maksimale të ndihmës, të përcaktuara në këtë kre.

2. Në rastin e ndihmës së dhënë për ndërmarrjet, që ofrojnë shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, vlera totale e ndihmës që i jepet përfituesit nuk e kalon vlerën 69 500 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind mijë) lekë për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Në rastin e garancive, në kuptimin e pikës 5, të kreut IV, të vendimit, garancia e dhënë ndërmarrjes nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe pjesa e garantuar e kredisë nuk kalon shumën prej 522 500 000 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.

4. Dhënësit e ndihmës i japin strukturave përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore informacionet e mëposhtme:

a) Një kopje të mandatit të shërbimit publik;

b) Vlerën totale të ndihmës;

c) Shpjegimin e mënyrës së llogaritjes së vlerës totale të ndihmës.

VII. KURSI I KËMBIMIT TË EUROS NË LEKË, NORMA E INTERESIT DHE E SKONTIMIT

1. Për zbatimin e nenit 8, të ligjit dhe të këtij vendimi, vlerat e shumave të mëposhtme caktohen për pesë vjet, si më poshtë vijon:

a) vlera 50 000 euro në 7 000 000 lekë;

b) vlera 100 000 euro në 14 00 000 lekë;

c) vlera 125 000 euro në 18 000 000 lekë;

ç) vlera 187 000 euro në 25 000 000 lekë;

d) vlera 250 000 euro në 35 000 000 lekë;

dh) vlera 375 000 euro në 50 000 000 lekë;

e) vlera 500 000 euro në 70 000 000 lekë;

ë) vlera 750 000 euro në 100 000 000 lekë;

f) vlera 3 750 000 euro në 522 500 000 lekë;

g)vlera 15 000 000 euro në 2 085 000 000 lekë.

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore me vendim mund të ndryshojë vlerat e mësipërme, në rastin kur rritja ose ulja e kursit të këmbimit të euros në lekë shkakton një ndryshim më të madh se 500 000 lekë të vlerës në lekë, të përcaktuar në pikën 1.

3. Kursi zyrtar i këmbimit të euros në lekë përcaktohet nga Banka e Shqipërisë mbi bazën e udhëzimit të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 66, datë 30.8.2006, "Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë".

4. Norma e interesit dhe e skontimit përcaktohen me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore për përcaktimin e normave të interesit.

VIII. NJOFTIMI I NDIHMËS *"DE MINIMIS*" DHE KONSTATIMI I LEJUESHMËRISË SË NDIHMËS

1. Ndihmat njoftohen pranë strukturës përgjegjëse për ndihmën shtetërore, e cila kontrollon nëse përmbushen kushtet e parashikuara në pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi, dhe ia përcjell njoftimin për shqyrtim Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

2. Ndihma njoftohet para dhënies, por njoftimi nuk pezullon pagesën e ndihmës.

3. Komisioni merr një vendim në të cilin konstatohet që ndihma e dhënë përmbush kushtet dhe si rrjedhim lejohet.

4. Nëse Komisioni nuk merr vendim brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, ndihma konsiderohet ndihmë e lejuar.

5. Komisioni merr një vendim për pezullim të ndihmës, nëse konstaton se një ose më shumë kushte të ndihmës *"de minimis"* nuk përmbushen. Ky vendim i njoftohet dhënësit brenda 30 ditësh nga data e marrjes së njoftimit. Komunikimi i këtij vendimi pezullon ndihmën, e cila duhet të shqyrtohet në bazë të kushteve përkatëse të ligjit.

6. Ndihma që nuk përmbush kushtet e mësipërme, që është jashtë fushës së zbatimit të këtij vendimi ose që mbulohet nga përjashtimet e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, njoftohet në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, dhe shqyrtohet në bazë të kushteve përkatëse të përcaktuara në ligjin e sipërpërmendur.

7. Ndihma, që nuk përmban një vlerë maksimale në të holla ose në ekuivalent bruto të grantit, nuk përmbush kushtet e ndihmës "*de minimis"* sipas këtij vendimi. Ndihma njoftohet në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, dhe shqyrtohet në bazë të kushteve e të

procedurave përkatëse të përcaktuara në ligjin e sipërpërmendur.

IX. DETYRIMET E DHËNËSIT DHE PËRFITUESIT TË NDIHMËS "*DE MINIMIS"*

1. Dhënësi i ndihmës "*de minimis"* i kërkon ndërmarrjes një deklaratë mbi çdo ndihmë *"de minimis"* të përftuar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës nënshkruan deklaratën, sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

2. Dhënësi vendos të japë ndihmën *"de minimis"* vetëm nëse shuma e ndihmës së re nuk i kalon vlerat maksimale të caktuara në këtë vendim, duke marrë parasysh shumat e mëparshme të ndihmës *"de minimis"*.

3. Dhënësi informon përfituesin e ndihmës për shumën e grantit në të holla ose për ekuivalentin bruto të grantit dhe të karakterit *"de minimis",* duke përdorur formularin përkatës, sipas modelit të miratuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

4. Dhënësi dhe përfituesi njoftojnë menjëherë për ndihmën "*de minimis*" pranë strukturës përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë (në vijim struktura).

X. MONITORIMI DHE REGJISTRI I NDIHMAVE "*DE MINIMIS"*

1. Me kërkesë të strukturës, dhënësi dhe përfituesi japin çdo informacion mbi natyrën, qëllimin, shumën dhe llogaritjen e grantit ose ekuivalentit bruto të grantit, mbi çdolloj ndihme tjetër të marrë nga ndërmarrja e vetme dhe çdo informacion, të kërkuar nga struktura, në lidhje me ndihmat e marra ose të planifikuara për t'u marrë nga e njëjta ndërmarrje e vetme.

2. Kur struktura vëren se ndihma e dhënë apo e planifikuar ose ndihmat e bashkuara i tejkalojnë vlerat maksimale përkatëse të parashikuara në këtë vendim, ajo hap një procedurë për shqyrtimin e ndihmës ose ndihmave në përputhje me nenet 19 e në vijim të ligjit.

3. Struktura mban një regjistër të ndihmave "*de minimis",* në përputhje me detyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore".

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 607, datë 31.8.2016

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 12 e 13, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si një institucion publik, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është institucion buxhetor, që financohet me fonde të buxhetit të shtetit dhe fonde nga programet dhe projektet e BE-së, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere, donacione të subjekteve fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja, si dhe çdo financim tjetër të ligjshëm.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për mision të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), si dhe administrimin e përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

4. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për detyrë:

a) identifikimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, që

miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit;

b) shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane;

c) organizimin, çdo katër vjet, sipas metodologjisë së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë, të institucioneve të arsimit të lartë, duke i renditur ato në bazë të këtij vlerësimi;

ç) miratimin, mbi bazën e konkurrencës së lirë ndërmjet aplikantëve, të fondeve për projektet e studimeve të doktoratës;

d) administrimin dhe përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor në sistemin e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e bazave elektronike të të dhënave;

dh) administrimin dhe bërjen publike të bazës të të dhënave, me të gjitha projektet e financuara prej saj, në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit;

e) dhënien e informacioneve, rekomandimeve e sugjerimeve Ministrisë së Arsimit e Sportit dhe institucioneve të tjera, lidhur me aspektet e politikave dhe strategjive sektoriale në fushën e kërkimit shkencor e inovacionit.

5. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ka përgjegjësi për:

a) shpërndarjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor, për institucionet e arsimit të lartë, qendrat dhe institutet kërkimore-shkencore në vend;

b) koordinimin e Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit të Programit të BE-së për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin;

c) komunikimin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe renditjen e njësive kryesore e bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) administrimin e fondeve të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e subjekteve publike e jopublike, që kanë në statusin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor;

d) paraqitjen, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të raportit vjetor të veprimtarisë së saj, pasi e ka miratuar paraprakisht në bordin e administrimit;

dh) bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit;

e) nxitjen e bashkëpunimit me sektorin e biznesit në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit dhe mbështetjen ndaj iniciativave të tij, në këtë fushë.

6. Për nevoja të realizimit të veprimtarisë së saj, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit shkëmben informacion me:

a) institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) institucionet e arsimit të lartë, qendra dhe institucione kërkimore-shkencore në vend;

c) institucione të tjera publike dhe jopublike, që lidhen me fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionin.

7. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizohet dhe funksionon nëpërmjet organeve dhe autoriteteve drejtuese të saj, të cilat janë bordi i administrimit dhe drejtori i Përgjithshëm.

8. Bordi i administrimit është organ kolegjial vendimmarrës, që kryesohet nga ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ka në përbërje:

a) ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike;

b) dy përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

c) drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) drejtorin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

d) përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë;

dh) përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve;

e) përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

9. Funksionet e bordit të administrimit janë:

a) Miraton, përpara miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit që do të financohen;

b) Miraton përbërjen e komisioneve të ekspertëve të vlerësimit të programeve dhe projekteve, sipas fushave të shkencës;

c) Miraton aktet e brendshme të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

ç) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

d) Miraton financimin e projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit dhe projektet e studimeve të doktoratës, bazuar në:

i) fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të miratuara nga Ministria e Arsimit e Sportit;

ii) grantin e punës kërkimore-shkencore;

iii) vlerësimin e komisioneve të ekspertëve të programeve dhe projekteve.

dh) Miraton rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë përpara se këto rezultate dhe renditja përfundimtare t'i komunikohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

e) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda katërmujorit të parë të vitit pasardhës, i cili bëhet publik.

10. Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe rregullores së tij të brendshme, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

11. Kryetari dhe anëtarët e bordit të administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

12. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është titullari i institucionit dhe përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

a) Drejton, koordinon dhe monitoron veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

b) Paraqet në Bordin e Administrimit, për miratim, aktet e brendshme që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

c) Nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga agjencia;

ç) Bashkëpunon me agjencitë homologe në vende të tjera, nëpërmjet vendosjes së kontakteve, nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit për shkëmbim të eksperiencave dypalëshe;

d) Informon Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe bordin e administrimit për veprimtarinë e agjencisë, sa herë i kërkohet;

dh) Harton dhe paraqet, brenda afatit të parashikuar në bordin e administrimit, raportin vjetor për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

e) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të financimit të kërkimit shkencor;

ë) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare.

13. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

14. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

15. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

16. Numri i punonjësve të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) i kalon AKKSHI-it. Për nëpunësit civilë të AKTI-t zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

17. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çështjet e përmbajtjes dhe të vlerësimit të projekteve, kontrakton ekspertë vendas e të huaj si pjesë e komisioneve të vlerësimit.

18. Programet dhe projektet në administrim të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) transferohen me të gjitha të drejtat dhe detyrimet pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

19. Të gjitha komisionet e ekspertëve të vlerësimit, të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, që kanë qenë përzgjedhur për vlerësimin e projekteve kombëtare të kërkim-zhvillimit dhe projekteve të bashkëpunimit shkencor dypalësh, qëndrojnë në detyrë deri në përzgjedhjen e ekspertëve të komisioneve të reja të vlerësimit. Raportet e vlerësimit që ata kanë hartuar gjatë kësaj periudhe, për vlerësimin e projekt-propozimeve të ndryshme, të paraqitura pranë Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, mbeten në fuqi dhe shërbejnë si bazë për financimin e projekteve të përzgjedhura nga Agjencia Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

20. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2016 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

21. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 608, datë 31.8.2016

PËR DHËNIEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "PETER MAHRINGER", SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2016–2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 39, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënësit e viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të para deri në vitin e katërt, për vitin shkollor 2016–2017.

2. Vlera e bursës do të jetë 95 200 (nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë për nxënës në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i "Fondacionit Shkollor Austriak", në mbështetje të kritereve ekonomike dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i "Fondacionit Shkollor Austriak", pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e

bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 609, datë 31.8.2016

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, TË ARSIMIT BAZË, "*DEUTSCH-ALBANISCHE SCHULE*" / "SHKOLLA GJERMANO-SHQIPTARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë, "*Deutsch-Albanische Schule*"/"Shkolla gjermano-shqiptare".

2. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla Gjermano-Shqiptare", do të ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: Rruga "Nikolla Nishku", nr. 15, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla gjermano-shqiptare", mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj (në gjuhën gjermane). Në lëndët si gjuha shqipe, letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë, mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

4. Forma e arsimimit në institucionin arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla gjermano-shqiptare", do të jetë arsimim me kohë të plotë.

5. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla gjermano-shqiptare", me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, për:

a) numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve të arsimit bazë, të regjistruar në fillim dhe që do të mbarojnë vitin shkollor, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;

c) aktin e regjistrimit në organin tatimor;

ç) listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor;

d) adresën e institucionit, adresën elektronike (e-mail) dhe numrin e telefonit.

6. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla gjermano-shqiptare", duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si edhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-padagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë, sipas rastit.

7. Ndryshimet që mund të pësojë institucioni arsimor privat, parauniversitar, i licencuar, në vendndodhjen dhe në infrastrukturën e godinës, shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pas miratimit të njësisë arsimore vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

8. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë, "Deutsch-Albanische Schule"/ "Shkolla gjermano-shqiptare", duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) Regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar);

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

d) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

dh) Kontrata e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

9. Dokumentacioni i paraqitur në pikat 6 e 8, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

10. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse e inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo do të kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtij institucioni arsimor, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11. Në rast se institucioni arsimor privat nuk hapet gjatë dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjekti e humbet të drejtën e hapjes së institucionit.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 611, datë 31.8.2016

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "ISSAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit privat të arsimit të lartë "ISSAT", Tiranë, të të gjitha njësive përbërëse të tij dhe mbylljen e të gjitha detyrimeve lidhur me veprimtarinë mësimore shkencore në të gjitha ciklet e studimit ku ushtron veprimtarinë.

2. Institucioni privat i arsimit të lartë "ISSAT", Tiranë, të arkivojë të gjithë dokumentacionin mësimor, administrativ dhe financiar, në Arkivin e Shtetit, në përputhje me kuadrin ligjor mbi arkivat, brenda një kohe sa më të shpejtë.

3. Vula e institucionit privat të arsimit të lartë "ISSAT" të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit privat të arsimit të lartë/personit juridik privat që i përfaqëson. Institucioni privat i arsimit të lartë "ISSAT" duhet të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të kenë ndaj studentit.

5. Për studentët, që nuk kanë përfunduar programet përkatëse të studimit, institucioni privat i arsimit të lartë "ISSAT" të përgatitë dosjen për çdo student, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve dhe t'ia vërë atë në dispozicion vetë studentit pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda një kohe sa më të shpejtë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Arkiva e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucioni privat i arsimit të lartë "ISSAT" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 612, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN "HALIMI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMIN NR. 33839/11)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen

e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen "Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimin nr. 33839/11, në shumën 755 150 (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, sipas listës së ankuesve në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve në çështjen "Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimin nr. 33839/11, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit, brenda 3 muajve nga dita që vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Titulli i çështjes dhe aplikimi	**Emri i aplikantëve (viti i lindjes)**	**Vendqëndrimi**	**Përfaqësuar nga**	**Paraqitja e çështjes**
"Halimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë" Aplikimi nr. 33839/11	Eni Kokona (1976)	Shqipëri	S.Puto, avokat	14 Mars 2011
	Lindita Kokona (1976)	Shqipëri		
	Xhejni Kokona (1978)	Shqipëri		
	Nirvana Rradheshi (1951)	Shqipëri		
	Shpresa Halimi (1969)	SHBA		
	Diana Kaltani Halimi (1936)	Kanada		
	Ermal Halimi (1959)	Shqipëri		
	Karolina Halimi (1935)	Shqipëri		
	Ariel Halimi (1963)	Shqipëri		

VENDIM
Nr. 613, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 17.3.2016, PËR ÇËSHTJEN "RISTA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMET NR. 5207/10, 24468/10, 36228/1, 39492/10, 39495/10, 40751/10 DHE 48522/10)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.3.2016, për çështjen "Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr.24468/10 (Gjikolli dhe Molla), nr. 39492/10 (Galanxhi dhe të tjerë), nr. 39495/10 (Frashëri dhe të tjerë), nr. 40751/10 (Merlika dhe të tjerë) nr. 48522/10 (Dhimertika dhe Nika), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1 dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi, me mjete të përshtatshme, i vendimit nr.981, datë 27 shtator 2001, i Gjykatës së Lartë, për aplikimin nr. 5207/10 (Rista), brenda 3 muajve nga data kur vendimi është bërë përfundimtar.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.3.2016, për secilën çështje.

5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve: "Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr. 24468/10 (Gjikolli dhe Molla), nr. 39492/10 (Galanxhi dhe të tjerë), nr. 39495/10 (Frashëri dhe të tjerë), nr. 40751/10 (Merlika dhe të tjerë) nr. 48522/10 (Dhimertika dhe Nika), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës së buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKUESVE PËRFITUES

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
1.	*Rista*, nr. 5207/10	Kozma Rista (1936)	Shqipëri	J. Mërtiri, avokat	12 janar 2010
2.	*Gjikolli dhe Molla,* nr. 24468/10	Kurtesh Gjikolli (1925), zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij Pakize Zajmi ose Gjikolli, Rajmonda Karapici ose Gjikolli, Adnan Gjikolli. Nuri Gjikolli (Xhikaj) (1930), zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij Ganimete Xhikaj, Përparim Xhikaj, Dhurata Xhikaj, Adrian Xhikaj, Pamela Xhikaj, Velson Xhikaj. Hysnije Xhikolli (1932), zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj; Muharrem Xhikolli (1954), Burhan Xhikolli (1957), Edmila Molla (Xhikolli) (1959) Muharrem Xhikolli (1954) Burhan Xhikolli (1957) Edmila Molla (Xhikolli) (1959)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Itali	S. Puto, avokat	16 prill 2010
3.	*Galanxhi dhe të tjerë* nr. 39492/10	Nexhip Galanxhi (1932) Ylli Galanxhi (1949) Rozalt Galanxhi (1971) Fredi Lara (1957) Florentina Galanxhi (1947) Esmeralda Trolai (1981) Lirika Asllani Lara (1946) Haxhire Zhegu Galanxhi (1938) Rexhina Lara (1981) Ariana Lara (1958) Livia Lara (1990)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Puto dhe A.Prifti (Memi) avokatë	9 korrik 2010
4.	*Frashëri and Others,* nr. 39495/10	Orhan Jegeni (1936) Kapllan Jegeni (1937) Nermin Bubani (1939) zëvendësuar nga trashëgimtarët Loredan Bubani (1939), Elvana Bubani ose Zaimi (1961),	Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S.Puto avokat	9 korrik 2009

		Gjergj Bubani (1966), Suat Jegeni (1942) Naide Shkodra (Frashëri) (1929) Fiqirete Frashëri (1930) Hajri Frashëri (1951) Hysref Frashëri (1956) Ilona Ziso (1962)	 Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri		
5.	*Merlika and Others,* nr. 40751/10	Gëzim Kaçiu (1956) Sajrie Kuta (Merlika) (1934) Lumnije Karami (Merlika) (1937) Luljeta Ndreu (Kaçiu) 1960) Liljana Kaçiu (1963) Shyqyri Merlika (1935) Kujtim Merlika (1941) Ilir Alija (Merlika) (1935) Ardjan Aliaj (1960) Hysen Kasmi (1946) Afrim Kaçiu (1958)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	10 qershor 2010
6.	*Dhimertika and Nika,* nr. 48522/10	Arjan Dhimertika (1961) Konde Dhimertika (1941) Engjell Dhimertika (1963) Jeta Dhimertika (1973) Evjeni Dhimertika (1938) Leonora Nika (Dhimertika) (1962) Gëzim Dhimertika (1972)	Shqipëri Greqi Greqi Greqi Shqipëri Shqipëri Gjermani	S. Puto, avokat	30 korrik 2010

SHTOJCA 2 – SHPËRBLIMI I DREJTË

No.	Aplikimi dhe numri	Dëmi Pasuror dhe dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1.	*Rista,* nr. 5207/10	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)
2.	*Gjikolli dhe Molla,* nr. 24468/10	1.562.100 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
3.	*Galanxhi dhe të tjerë* nr. 39492/10	216.600 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
4.	*Frashëri and Others,* nr. 39495/10	3.330.500 (tre million e treqind e tridhjetë mijë e pesëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
5.	*Merlika and Others,* nr. 40751/10	1.171.800 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind) euro	Nuk ka pretendime (nuk është paraqitur pretendim specifik)
6.	*Dhimertika and Nika,* nr. 48522/10	4.416.900 (katër milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë